



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË  
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË**

Nr. 1205/3 prot.

Tiranë, më 06.09.2023

**NJOFTIM ME SHPALLJE**

**TË VENDIMIT NR. 1205/1, DATË 21.07.2023 TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, "PËR ARKIVIMIN PAS SHQYRTIMIT FILLESTAR TË ANKESAVE TË BASHKUARA TË PARAQITURA NGA SHTETËSJA ZNJ. TEUTA PAPA"**

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesat e znj. Teuta Papa, me nr. 2371 prot, datë 06.09.2022; nr. 2371/2 prot, datë 13.09.2022; nr. 2371/3 prot, datë 22.09.2022; nr. 2371/4 prot, datë 22.09.2022; nr. 2371/5 prot, datë 22.09.2022; nr. 2371/6 prot, datë 22.09.2022; nr. 2371/7 prot, datë 22.09.2022; nr. 2371/8 prot, datë 22.09.2022; nr. 2371/9 prot, datë 03.10.2022; nr. 2371/10 prot, datë 03.10.2022; nr. 2371/11 prot, datë 03.10.2022; nr. 2371/12 prot, datë 03.10.2022; nr. 2371/13 prot, datë 03.10.2022; nr. 2371/14 prot, datë 03.10.2022; nr. 2371/15 prot, datë 07.10.2022 ndaj veprimtarisë gjyqësore të magjistratit z. V.S., gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Vlorë dhe me vendimin nr. 1205/1, datë 21.07.2023 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesave të bashkuara të paraqitura nga shtetësja z. Teuta Papa", bazuar në nenin 120, pika 1, shkronja "b", nenin 121, pika 2, shkronja "a" të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe nenit 214 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, ka vendosur arkivimin e ankesës. Vendim duhet t'i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e komunikuar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë", Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Bashkisë Vlorë, sipas adresës së lënë nga ankuesja: Lagjja "28 Nëntori", Rruga "At Kristo Negovani", pallati nr 425, Vlorë;
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: [www.ild.al](http://www.ild.al).

Shpalljet që do të afishohen në ambientin e bashkisë përkatëse, do të hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**

